

## **INFORMACION NË LIDHJE ME PRETENDIMIN E ZËRIT TË AMERIKËS PËR FAVORIZIM TE SHOQËRISE DH-ALBANIA NE DHENIEN E LICENCES NE ZBATIM**

Referuar kronikës së publikuar nga “Zëri i Amerikës” se shoqëria DH Albania është favorizuar në sigurimin e licencës në zbatim përpara regjistrimit në QKB, **Sekretariati Teknik i Komisionit të Posaçëm të Liçencimit, sqaron se nga ky komision është zbatuar procedura ligjore dhe mbledhja e datës 30 Korrik 2018 ka marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë DH Albania për njësimin e licencës së huaj vetëm pasi shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, përfshirë edhe dokumentin e pretenduar nga “Zëri i Amerikës”, aktin e regjistrimit në QKB.**

Nga fillimi i procedurës së aplikimit deri në kalimin e dosjes për vendimmarrje drejt Komisionit, subjektet sipas ligjit kanë të drejtën të depozitojnë dokumente plotësuese në funksion të aplikimit të tyre. Sekretariati shqyrton dhe relatton drejt Komisionit vendimmarrës vetëm aplikimet të cilat rezultojnë me dosje të plotë të dokumentacionit ligjor të kërkuar.

Më në detaje sqarojmë se, shoqëria DH Albania, me kërkesën e saj të datës 13.07.2018, protokolluar në MIE me nr.1138 prot., datë 13.07.2018, ka aplikuar për njësimin e licencës së huaj, në fushën e zbatimit në ndërtim. Shoqëria me shkresën e datës 18.07.2018, e protokolluar në MIE me nr.1162 prot., datë 18.07.2018, e deri në datë 27.07.2018 ka paraqitur dokumentacion plotësues të aplikimit për njësim të licencës së huaj.

Bëjmë me dije se njësimi i licencës nga vendi i origjinës së shoqërisë DH ALBANIA është bërë konform gërmës a) të pikës 3) të Kreut III, të rregullores së miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Sekretaria Teknike e Komisionit të Posaçëm, pasi vlerësoi plotësimin e dokumentacionit të paraqitur referoi aplikimin e kësaj shoqërie, së bashku me aplikimin e 33 shoqërive të tjera, ku paraqiteshin edhe 3 aplikime shoqërisht për njësim të licencës nga vendi i origjinës ngjashmërisht me aplikimin e shoqërisë DH Albania, pranë Komisionit, i cili në mbledhjen e datës 30.07.2018 shqyrtoi të gjitha aplikimet që rezultojnë të plota në përputhje me kërkesat ligjore. **Sipas përcaktimeve të kësaj rregullore, sekretariati teknik shqyrton aplikimet që rezultojnë me dokumentacion provues, dhe nëse rezulton i plotë ja relatton Komisionit për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Në rastin konkret, sekretariati ja ka dërguar dosjen Komisionit për shqyrtim dhe vendimmarrje vetëm pasi dosja është plotësuar me të gjitha dokumentet nga subjekti kërkuar.**

Bazuar në shkronjën “a”, të pikës 3, Kreu III, të rregullores së miratuar me VKM nr.42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, si dhe mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria, Komisioni miratoi njësimin e licencës së shoqërisë, duke u bazuar në paragrafin 2, të gërmës ”a”, të pikës 3, Kreu III, të rregullores, që përcakton se “*Shoqëritë e huaja që aplikojnë për licencim*

*njehsojnë licencën që disponojnë nga vendi i origjinës duke zbatuar të njëjtat procedura për kategorizimin dhe klasifikimin, si dhe shoqëritë shqiptare”.*

Në bazë rregullore Kreu II, pika 4, nënpika V, të VKM nr.42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, Sekretaria e Komisionit, kur aplikimi rezulton me dokumentacion të plotë, brenda 7 ditëve propozon komisionit shqyrtimin e kërkesës. Sekretaria për çdo rast referon të gjitha aplikimet e paraqitura pranë Komisionit, dhe prezanton të gjitha aplikimet që janë të plotësuar me dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores. Edhe në këto rast, pranë komisionit është relatuar ky aplikim brenda afatit ligjor. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria, përshkruhet si me poshte:

- Kërkesa, e nënshkruar nga përfaqësuesi i degës së shoqërisë së huaj, z. Avdjol Dobi.
- Formular aplikimi i shoqërisë, ku jepen të dhënat e shoqërisë, rezidenca dhe adresa, të dhënat e kontaktit, përfaqësuesin ligjor, drejtuesit teknik me të cilët kërkohet të përfitojë njehsimin e licencës së huaj.
- akti i themelimit të shoqërisë mëmë, (përkthimi dhe noterizimi i dokumentit të apostiluar nga vendi i origjinës)
- statuti i shoqërisë mëmë (përkthimi dhe noterizimi i dokumentit të apostiluar nga vendi i origjinës)
- Ekstrakti historik i regjistrimit tregtar në të degës së shoqërisë së huaj të regjistruar në Shqipëri pranë QKB, mbi të dhënat e subjektit- i njehsuar nga noteri Xhevahire Brahaj.
- Licenca e shoqërisë Dunëell Haberman LLC, me nr.DH30561209, me vlefshmëri deri më 22.08.2023, lëshuar nga Bordi i Shtetit të Delaëare (përkthimi dhe noterizimi i dokumentit të apostiluar nga vendi i origjinës)
- Dokument mbi sistemin e klasifikimit të licencave në vendin e origjinës (përkthimi dhe noterizimi i dokumentit të apostiluar nga vendi i origjinës)
- Vërtetimi për taksat, falimentin, çështje gjyqësore ose veprimtari joligjore të shoqërisë mëmë (përkthimi dhe noterizimi i dokumentit të apostiluar nga vendi i origjinës)
- Bilanci 2017, me përmbledhje për 3 vitet e fundit të shoqërisë mëmë (përkthimi dhe noterizimi i dokumentit të apostiluar nga vendi i origjinës)
- Kontratat e punës midis shoqërisë dhe drejtuesve teknikë (përkthimi dhe noterizimi i dokumentit të apostiluar nga vendi i origjinës),
- Diplomat e drejtuesve teknikë (përkthimi dhe noterizimi i dokumenteve të apostiluara nga vendi i origjinës):
- CV dhe rekomandime për drejtuesit teknikë (të përkthyer nga përkthyes shqiptar dhe të noterizuara).
- Vetdeklarime të drejtuesve teknike
- PAGESA E TARIFËS SË APLIKIMIT 1 EURO

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kërkuar verifikim dokumentacioni, nëpërmjet kanaleve diplomatike, në SHBA. Pas përgjigjes së marre ku rezulton se dokumentacioni që lidhet me datën e krijimit të shoqërisë në vendin e origjinës nuk është i njëjtë me dokumentacionin e paraqitur prej degës së shoqërisë në Shqipëri gjatë aplikimit për njehsimin e licences në vendin e origjinës, Ministria ka përcjellë trajtimin e këtij rasti pranë sekretarisë teknike të Komisionit të Posacem, i cili u trajtua në një mbledhje të posacme dhe u morr vendimi Nr. 24, DATË 13. 12. 2018, për revokimin e licences së njehsuar.

Licenca e shoqërisë DH Albania me vendim NR. 24, DATË 13. 12. 2018, të Komisionit të Posacëm, mori vendim në zbatim të pikës 1/a/I, të Kreut VII të rregullores “Heqjen e të drejtës së ushtrimit të aktivitetit në fushën e zbatimit në ndërtim, për një periudhë 5 vjet” për shoqërinë “DH-ALBANIA”, degë e shoqërisë së huaj, me administrator z. Avdjol Dobi, si dhe në zbatim të shkronjës “b”, të po kësaj pike, kallëzimin pranë organit të akuzës.

***I gjithë dokumentacioni tanimë është në dispozicion të organit të akuzës i cili po kryen hetimet e nevojshme për zbardhjen e asaj çka ka ndodhur dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të përgjegjësve për aktin e falsifikimit.***

---

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.